



AKT THEMELIMI

(KONTRATE)

E hartuar sot ne Korce me dt. 19.7.1996 midis:

1. POTHITOS STASINOPOULOS i biri i NIKOLAS ,nenshtetas grek me banim ne Athine ,rruga Emporos Arianou Nr.9,me nr.pasaporte KS 434035.
2. FIRMA E KONFEKSIONEVE PER FEMIJE SH.A. me seli ne Athine ne rrugen Arianou 9,Peristeri 12131, per perfaqesimin juridik te se ciles eshte Z, Pothitos Stasinopoulos sipas protokollit te dates 12.6.1996.

Palet e mesiperme pasi u merren vesh vendosen:

NENI 1

Te krijojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuara e cila do te emertohet "THE BLUE STAR SH.P.K."

NENI 2

Selia e shoqerise "THE BLUE STAR SH.P.K." do te jete ne qytetin e Korces ne rrugen Gjergj Kastrioti PLL.II

NENI 3

Objekti i veprimtarise te shoqerise eshte prodhimi per llogari te saj dhe per te trete (FASON) te llojeve te rrobave per gra,burra e femije si dhe rroba te thurura ne pergjithesi si dhe tregtimi i produkteve te gatshme dhe gjysem te gatshme te shitjes me shumice dhe pakice ne te gjithe qytetet e Shqiperise.Do te importoje lende te para dhe ndihmese si dhe produkte te gatshme,do te krijojte shoqeri dhe filiale dhe do te merret me importime dhe eksportime ne pergjithesi.

Do te hape linja prodhimi veshjesh ne Korce te Shqiperise si dhe ne qytete te tjera.Do te krijojte shoqeri te tjera tregtare ne bashkepunim me persona fizike dhe juridike te vendit si dhe jashte vendit.

Shoqeria do te kete te drejte te ndermarre aktivitet ne objekte te luajteshme dhe te paluajteshme,tregtare dhe aktivitet publik,te nevojshem dhe te dobishem per realizimin e qellimeve te saj.

NENI 4

Kohezgjatja e veprimtarise te shoqerise "THE BLUE STAR SH.P.K." eshte 20(njzet) vjet duke filluar nga data e miratimit dhe e rregjistrimit te saj nga gjykata si person juridik.

Kohezgjatja e veprimtarise te shoqerise mund te shkurtrohet ose te zgjatet me vendim te Asamblese te ortakeve te saj.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise "THE BLUE STAR SH.P.K." eshte 100.000 (njehqinmije) lek ose 1000(njemije) dollare USA,i ndare ne 100(njegind) pjese ku cdo pjese vleresohet me 1000(njemije)leke.

Themeluesit e shoqerise marrin pjese ne formimin e kapitalit themeltar te shoqerise si me poshte:

1. STASINOPOULOS POTHITOS ka 10(dhjete) pjese nga 1000 leke qe bejne 10.000leke(dhjetemije leke) ose 10% te kapitalit.

2. FIRMA E KONFEKSIONEVE PER FEMIJE Sh.A. ka 90(nenetedhjete) pjese nga 1000 (njemije) leke qe bejne 90.000(nenetedhjetemije) leke ose 90% te kapitalit. Kapitali i shoqerise mund te shtohet ne te holla ose ne natyre me makineri pajisje etj.

NENI 6

Fitimi i shoqerise "THE BLUE STAR SH.P.K." do te ndahet :

1. STASINOPOULOS POTHITOS 10%.

2. FIRMA E KONFEKSIONEVE PER FEMIJE SH.A. 90%.

NENI 7

Themeluesit rane dakort qe per drejtimin e organizimin e veprimtarise te shoqerise te caktohet si administratore Z.POTHITOS STASINOPOULOS qe do te veproje dhe do te perfaqesoje shoqerine ne kryerjen e veprimtarise te ndryshme ne interes te shoqerise.

NENI 8

Shoqeria "THE BLUE STAR SH.P.K." do te filloje veprimtarine e saj pasi te behet rregjistrimi i saj si person juridik nga gjykata e rrethit te Tiranes dhe te pajiset me lejen e ushtrimit te veprimtarise nga Zyra Tatimore.



KORCE me 19.7.1996

THEMELUESIT E SHOQERISE TREGETARE "THEBLUE STAR SH.P.K."

1. POTHITOS STASINOPOULOS

2. " FIRMA E KONFEKSIONEVE PER FEMIJE SH





S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA " THE BLUE STAR SH.P.K."

Ne mbeshtetje te ligjit te Republikes te Shqiperise Nr.75I2,date IO.8.I99I "Per sanksionimin dhe mbrajtjen e prones private,te nismes te lire,te veprimtarive private te pavarura dhe te privatizimit",te ligjit Nr.7764 dt.2.II.I993 "Per investimete e huaja" dhe Nr.7638 dt.I9.II.I992 "Per shoqerite tregetare",me aktine e themelimit te dates u krijue shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuara"THE BLUE STAR SH.P.K e cila do te vazhdoje veprimtarine e saj sipas ketij statuti.

KREU I

EMERTIMI,SELIA,OBJEKTI,DHE KOHEZGJATJA E VEPRIHTARISE TE SHOQERISE.

NENI I

Me kontraten e themelimit I9.7.I996 eshte krájuar Shoqeria me Tregetare me Pergjegjesi te Kufizuara "THE BLUE STAR SH.P.K."

NENI II

Selia e shoqerise "THE BLUE STAR SH.P.K." eshte ne qytetin e Korces te Shqiperise,ne rrugen "Gjergj Kastrioti" Pll.II.

NENI 3

Objekti i shoqerise "THE BLUE STAR SH.P.K." eshte:

Prodhimi per llogari te saj e per te trete (FASON) te llojeve te rrobave per gra e per burra e femije si dhe te rrobave te thurrura ne pergjithesë si dhe tregetimi i produkteve te gatshme dhe gjysem te gatshme,te shitjes me shumice dhe pakice ne te gjitha qytetet e Shqiperise.Do te importoje lende te pare dhe ndihmese si dhe produkte te gatshme,do te krijoje shoqeri dhe filiale dhe do te merret me importime dhe eksportime ne pergjithesi.

Do te hape linja prodhimi veshjesh ne Korce te Shqiperise si dhe ne qyt qytete te tjera.Do te krijoje shoqeri tregetare ne bashkepunimin me persona fizike dhe juridike te vendit si dhe jashte vendit.

Shoqeria do te kete te drejte te ndermarre aktivitet me objekte te luajtshme dhe te paluajtshme,tregetare dhe aktivitet publik te nevojshem dhe te dobishem per realizimin e synimeve dhe te qellimeve te saj.



NENI 4



Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë të saj sipas vendimeve që do të marrë mbledhja e Asamblesë të themeluesve.

NENI 5

Kohezgjatja e veprimtarisë të shoqërisë është 20 (njëzet) vjet duke filluar nga dita e miratimit dhe regjistrimit të saj si person juridik në gjykatë.

Kohezgjatja e shoqërisë mund të shkurtohet ose të zgjatet me vendim të Mbledhjes të Asamblesë të ortakeve themelues. Mbledhja e Asamblesë të Ortakeve themelues mund të vendosë shpërberjen e shoqërisë në çdo kohë.

KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë "THE BLUE STAR SH.P.K." është 100.000 (njëqind mijë lek) LEK ose 1000 (njemijë) USD, i ndarë në 100 (njëqind) pjesë ku secila pjesë vlerësohet me 1000 (njemijë) lek.

Themeluesit e shoqërisë marrin pjesë në formimin e kapitalit themeltar si më poshtë;

1- STASINOPOULOS POTHITOS ka 10 (dhjetë) pjesë nga 1000 lek që bëjnë 10.000 (dhjetemijë) lek ose 10% të kapitalit.

2- SHOQËRIA E PRODHIMIT TË KONFEKSIONEVË ka 90 (nëntëdhjetë) pjesë nga 1000 lek që bëjnë 90.000 (nëntëdhjetemijë) lek ose 90% të kapitalit.

NENI 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakesohet me vendim të mbledhjes të themeluesve të saj. Shtimi i kapitalit mund të bëhet me lek, dollarë ose në natyrë makineri, pajisje, pjesë këmbimi etj.

KREU III

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 8

Organi më i lartë i shoqërisë "THE BLUE STAR SH.P.K." është Asambleja e ortakeve themelues të saj.

Asambleja e shoqërisë ka të drejtë të ~~kurkëjë~~ caktojë një ose disa administratore për drejtimin e veprimtarisë të saj, të ndryshojë objektin e veprimtarisë të saj, të shtojë ose të pakesojë kapitalin, të shperbejë shoqërinë të zgjase ose të shkurtojë kohezgjatjen e veprimtarisë, të hapë filiale, agjencitë agjensi e vendqendrime të tjera operative, të caktojë eksperte kontabel, të therrase në raport administratorët, të oranojë ortake të tjera në shoqëri.



Administrator i shoqerise caktohet Z.STASINOPOULOS POTHITOS.

Administratori i shoqerise eshte i veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem ~~te~~ dhe te jashtezakonshem te saj pa asnje lloj perjashtimi. Ai ka te drejte te kryeje te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per aritjen e qellimit te shoqerise. Ai ka te drejte midis te tjerash te bleje te shese ose te kembeje pasuri, te lidhet me shoqeri te tjera brenda e jashte Shqiperise per arritjen e qellimeve te ve primtarise ekonomike te permendur ne kete statut. Ai kryen cdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave shteterore dhe private, institucioneve financiare dhe bankare per garancite e veprimet hipotekuese, veprime depozitimi, pagesa dhe arketime, qarkullim te letrave me vlere ne tregun e parase etj per llogari te shoqerise apo te te treteve.

Administratori per veprimet e permendura me siper njofton dhe jep llogari para Asamblese te themeluesve te shoqerise.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardheniet me te tretet, ne emer te shoqerise, ne te gjitha rethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe ky statut i jep Asamblese te shoqerise.

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit, perjashtuar rastin kur pranon se te tretet e dinin qe akti i administratori e kalonte objektin e veprimtarise te shoqerise.

KREU IV

MARDHENIET E PUNES

NENI 10

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se pune. Per ceshtje qe nuk rregullohen ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Mardheniet e te punesuarve ne shoqeri zgjidhen nga gjykatat shqiptare. Kur pala ankuese eshte person i huaj zgjidhet nga organi qe percaktohet ne kontraten e punes.

Punonjesi e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit qe realizon sj shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise se saj, nese ne kontraten e punes nuk parashikohet ndryshe. Per punen e tyre punonjesi marrin pagen sic eshte parashikuar ne kontraten e punes. Shoqeria dhe punonjesi mund te merren vesh ne kontraten e punes qe punonjesi i huaj nje pjese te pages te punes ta perfitoje ne devize.

NENI 11

Administratori i caktuar nga Asambleja e themeluesve te shoqerise nuk mund te ushtroje aktivitet konkurues te cdo lloji per llogari te tij ose te te treteve, pervec atyre te caktuara nga statuti ose te autorizuara nga Mbledhja e Asamblese te ortakeve. Per cdo shkelje ne kete drejtim Administratori

tori shkarkohet nga detyra dhe pergjigjet per demet e shkaktuara.

NENI 12

Te gjithë te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes te shoqerise. Sekret pune paraqesin shkresat dhe aktet te cilat me ligj dhe dispozita te vecanta jane shpallur sekret pune.

Te dhenat informative ,bilancet, informacionet mbi politiken ekonomike te shoqerise qe u jepen organeve te miratuara, nenshkruhen nga administratori i shoqerise.

Detyrat per ruajtjen e sekretit te punes nga te punesuarit vazhdojne edhe pas largimit te tyre nga shoqeria.

KREU V

PERFAQESIMI I SHOQERISE

NENI 13

Perfaqesimi i shoqerise "THE BLUE STAR SH.P.K.2 i perket Administratorit te saj ose te Administratoreve te tjere te caktuar nga Asambleja e themeluesve.

Administratori i shoqerise e perfaqeson ate ne organet gjyqesore ne gjykim caktom e pushon avokate per ceshtjet ne gjykim.

Administratori harton raportin e administrimit, inventarin dhe llogarite vjetore te shoqerise.

Nese eshte e nevojshme Asambleja e themeluesve te shoqerise cakton eksperte kontabel dhe vetem pas raportimit te tyre miraton llogarite.

Ortaket themelues mund te delegojne kompetencat e tyre.

Vendimet ne mbledhjen e Asamblese te ortakeve merren me shumice votash.

Cdo ortak ka q vota sa ka pjese dhe ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Vendimet e mbledhjes te Asamblese te themeluesve te shoqerise evdntohen ne nje rregjister .

KREU VI

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 14

Veprimet ekonomike-financiare te shoqerise mbyllen me 21 Dhjetor te cdo viti, pervec urdherave te vecanta qe jep administratori.



NENI 15

Fitimi i realizuar nga shoqeria "THE BLUE STAR SH.P.K." u takon themeluesve te shoqerise:

- 1- STASINOPOULOS POTHITOS 10%.
- 2- FIRMA E KONFEKSIONEVE PER FEMIJE SH.A. 90%.

KREU VII

DISPOZITA TE PERGJITHSHME



NENI 16

Anetaret themelues mund te largohen nga shoqeria ne cdo kohe, duke njoftuar me goje ose me shkrim anetaret themelues.

Me largimin nga shoqeria preferohen te blejne pjeset e kapitalit anetaret qe mbeten.

NENI 17

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, do te zbatohet ligji shqiptar dhe plotesimet qe mund ti behen ketij statuti nga mbledhja e themeluesve.

Ndryshimet ose plotesimet e statutit behen ne te njejten menyre e procedur me te cilen nxirret vete statuti.

Statuti hyn ne fuqi pas miratimit te shoqerise ne gjykate.

NENI 18



dhe rregjistrimit
Statuti hyn ne fuqi pas miratimit te shoqerise ne gjykate.
Ky statut u perpilua ne gjuhen shqipe ne kater kopje.

KORCE 19.7.1996

THEMELUESIT E SHOQERISE "THE BLUE STAR SH.P.K."

1- STASINOPOULOS POTHITOS

2- FIRMA E KOFEKSIONEVE PER FEMIJE SH.A.



REPUBLIKA E SHQIPERISE

K O P E R I A

Nr. 780 Kol.

Nr. 114 Rep.

V E R T E T I M

Sot me daten 17 .01.1997, para meje Shkencdie Shahu Notere ne qyte-

tin e Tiranes, u paraqit E.Pothitos Stasinopoulos, i biri i Nikolas, i datlindjes 1950 lindur dhe banues ne Emperos Arrianou Nr.9, Athine te Greqise, me pasaporte KS-434035 per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta e tij personale, m dhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i cili neneshkroi para meje Aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise " THE BLUE STAR "SH.P.K. para jashte kesaj zyre.




E R E

Shahu



STATUTI I SHOQERISE

« FIVE OAKS ENTERPRISES LIMITED »



1. Ne dispozitat e meposhtme te ketij Statuti:
Termi « Qipros » presupozon Republiken e Qipros.
Termi «Ligji» presupozon Ligjin "Per Shoqerite",
Kapitullin 113, me ndryshimet respektive te tij.
Termi «Vula» presupozon vulen e zakonshme te
Shoqerise.

Termi «Sekretari» presupozon cdo person qe emerohet
per te kryer detyrat e sekretarit te Shoqerise.

Pervec rasteve, sipas te cilave rezulton nga teksti
qellimi per te kunderten, termi "me shkrim" duhet
interpretuar se perfshin shtypjen, litografine, fotografine
dhe menytrat e tjera, me ane te te cilave pasqyrohen ose
riprodhohen fjale ne forma te dukshme.

Pervecse, nese nga teksti rezulton ndryshe, termat
ose fjalet e perfshira ne keto dispozita kane ate kuptim qe
ju ka dhene ligji si dhe amendamentet e cdo ligji tjeter qe
ka qene ne fuqi daten kur keto dispozita jane bere te
detyrueshme per shoqerine.

PERJASHTIMI I TABELES "A"

2. Dispozitat e perfshira ne Katalogun "A" te
Shtojces se Pare te Ligjit (Per Shoqerite) nuk mund te
zbatohen, pervec rasteve te vecanta kur ato perfshihen ne
dipozitat e ketij statuti.

DISPOZITA HYRESE

3. Shoqeria eshte Shoqeri private dhe si rrjedhoje:

(a) E drejta e transferimit te aksioneve te kapitalit
kufizohet sipas menyres qe percaktohet ne vijim.

(b) Numeri i anetareve te shoqerise (pa perfshire
personat qe jane ne sherbim te shoqerise si dhe personat,
te cilet ishine ne sherbim te shoqerise para, gjate dhe pas
perfundimit te ketij sherbimi vazhduan te jene anetare te
kesaj shoqerie) kufizohet ne 50 veta. Eshte e kuptueshme
qe, sa here dy ose me shume persona zoterojne bashkarisht
nje ose me shume aksione te shoqerise, ata llogariten, ne
zbatim te kesaj dispozite, si nje anetar i vetem.

(c) Ndalohet ftesa ne publik per rregjistrim te cdo
aksioni ose letre me vlere ne shoqeri.

(d) Shoqeria, ne asnje rast nuk ka kopetencen e
emetimit te titujve te aksioneve te kapitalit tek pruresi (
share warrants to bearer).

P U N A

4. Shoqeria duhet te depozitoje cdo shpenzim paraparak
ose shpenzim tjeter, te bashkenenshkruaje, adoptoje ose

zbatoje si dhe te marre ose te vazhdoje (nen ndryshime te tilla, te cilat palet kontraktuese i kane pranuar dhe Keshilli Administrativ i ka miratuar) cdo lloj marrveshje, operacion ose aktivitet te nenshkruar ose ushtruar (sipas rastit) para themelimit te shoqerise, sic e ka vendosur shoqeria.

KAPITALI AKSIONER DHE DIFERENCIMI I TE DREJTAVE

5. Aksionet duhet te vendosen ne dispozicion te shoqerise, e cila, ne zbatim te Dipozites 3 dhe te parashikimeve te Dipozites vijuese, mundet qe me ane te vendimeve te zakonshme te jape ose, ndryshe, te vere ne dispozicion, sipas pelqimit te saj, tek anetaret kohen dhe pergjithesisht kushtet dhe predispozitat, duke presupozuar ne kete menyre se ata nuk deshirojne emetimin e aksioneve me zbritje (at a discount), perjashtuar rastet qe parashikon neni 56 i Ligjit (Per Shoqerite).

6. Pervec se, nese Shoqeria ne Asamblene e saj te Pergjithshme vendos ndryshe, ne cdo rast, aksionet fillestare te paemetuara dhe te padhena dhe aksionet e krijuara rishtas (created), para se ato te emetohen, ju ofrohen anetareve, ne proporcion me numerin e aksioneve te tyre qe ata zoterojne. Kjo oferte duhet te behet nepermjet njoftimit, duke caktuar numerin e aksioneve te ofruara dhe afatin. N.q. se miratimi nuk jepet brenda ketij afati, oferta konsiderohet e refuzuar dhe nese brenda ketij afati, nga ana e personit qe ju be kjo oferte jepet pergjigje negative per aksionet e ofruara, shoqeria mundet qe, ne zbatim te ketyre dispozitave, keto aksione ti vere ne dispozicion sipas gjykimit te saj dhe me menyren me te leverdishme per shoqerine. Gjithashtu, shoqeria mund te vere ne dispozicion aksione te tille, te rinj ose fillestare, sic parashikohet me lart, te cilet ju ofrohen prsonave te legjitimituar ne proporcion me numerin e aksioneve ose per arsyje te cdo veshtiresie tjeter, qe duhet evituar per ndarjen e tyre, nuk mundet qe ato, sipas mendimit te shoqerise, te ofrohen lehtesisht sipas menyrave te parashikuara me lart.

7. Pa ndikuar tek cdo e drejte e vecante, e dhene me perpara tek zoteruesit e aksioneve ekzistuese ose kategorise se aksioneve, cdo aksion i shoqerise mundet qe te emetohet me keto te drejta preference ose te drejta te tjera ose me kufizime te tilla ne lidhje me te drejten e votes.

8. Ne zbatim te dispozitave te nenit 57 te Ligjit per shoqerite, nepermjet vendimeve te zakonshme, mundet te emetohen aksione te privilegjuara me kushtin qe ato duhet te blihen ose shoqeria mundet qe te zgjedhe blerjen e tyre

ne kushte te tilla dhe menyra te tilla, sic ajo deshironte para emetimit te tyre(aksioneve).

9. N.q.se, ne cdo kohe, kapitali i shoqerise eshte i ndare ne aksione te klasave te ndryshme, te drejtat qe i perkasin cdo klase, mundet, pavaresisht nese shoqeria eshte ne procesin e shperberjes ose jo, te ndryshohen pas miratimit me shkrim te zoterueseve(ortakeve) qe zoterojne 3/4 e aksioneve te emetuara te kategorise (klases) ne fjale ose pas marrjes se vendimit te jashtezakonshem ne mbledhjen e vecante te Asamblese se Pergjithshme te zoteruesve te aksioneve te kesaj klase.

10. Te drejtat qe i perkasin zoterueseve te aksioneve te cdo klase, te emetuara me te drejten e preferences ose me te drejte tjeter te tille, nuk mund (n.q.se ne menyre taksative parashikohet ndryshe ne kushtet e emetimit te aksioneve te klases ne fjale) te ndryshojne si pasoje e krijimit ose emetimit te aksioneve te tjera, te klasifikuara ne te njejten klase.

11. Shoqeria mundet te ushtroje, ne zbatimin te nenit 52 te Ligjit per Shoqerite, kopetencat e dhena tek ajo ne lidhje me pagesen e perfitimit, duke presupozuar se perqindja ose shumja e perfitimit qe duhet te paguhet dhe qe eshte miratuar, te llogaritet sipas dispozitave te nenit per perfitimet, por me kushtin qe perfitimi nuk duhet te kaloje mbi 10% te vleres se aksioneve te emetuara. Ky perfitim i tille mundet te paguhet ose nepermjet pageses kesh ose nepermjet shlyerjes plotesisht ose pjeserisht te aksioneve, ose nepermjet pageses pjeserisht sipas njeres menyre dhe pjeserisht sipas menyres tjeter. Shoqeria mundet qe per emetimin e aksioneve te paguaje edhe shperblimet e ndermjetesve.

12. Pervec rasteve qe parashikon ligji per shoqerite, asnje person tjeter nuk duhet te njihet nga shoqeria si zoterues i aksioneve ose shoqeria ne asnje menyre nuk detyrohet qe te njohe interesa, qe rrjedhin nga e drejta fizike, mbi cdo aksion te emetuar (pervec rasteve kur ne keto dispozita ose nga ligji parashikohet ndryshe) perves te drejtes absolute te zoteruesit te regjistruar per zoterimin e plote te aksionit.

13. Cdo person, emri i te cilit eshte i regjistruar ne Regjistrin e Anetareve, ka te drejte qe brenda 2 muajeve nga data e dhenies se aksioneve ose depozitimit te aktit te transferimit te aksioneve te marre falas nje certifikate per aksionet e tij ose kur ai merr me shume se nje certifikate per aksionet e tij, duhet te paguaje 15 sent per secilen certifikate, pervec certifikates se pare, gjithmone sipas vendimit te Keshillit Administrativ. Cdo

certifikate duhet te kete vulen e shoqerise dhe numerin e naksionve si dhe shumen e paguar per to. Eshte e kuptueshme se persa i perket aksionit ose aksioneve, te zoteruara bashkarisht nga shume se nje person, shoqeria nuk eshte e detyruar te jape me shume se nje certifikate dhe nje certifikate e dhene per nje aksion te tille, llogaritet e dhene per te gjithë zoteruesit e tij.

14. Ne rast se ndryshimi, humbjeje ose demtimi te certifikates, ajo duhet te ripërterihet, duke paguar 25 sent ose me pak se kjo shume dhe me te njejtet kushte, me te njejtat elemente dhe me te njejten garanci dhe me pagesen e shpenzimeve reale te shoqerise, por gjithmone, sipas percaktimit te Keshillit Drejtues te shoqerise.

15. Shoqeria duhet te mos jape, direkt ose indirekt, ose ne formen e kredise, garancise, sigurimit ose ndryshe, asnje asistence ekonomike tek asnje person qe ka lidhje me blerjen e kryer ose te ardhshme te aksioneve ose me regjistrimin per aksionet e shoqerise. Gjithashtu, shoqeria duhet te mos jape kredi per asnje qellim si ofrim per sigurimin e aksioneve te saj ose te aksioneve te shoqerise drejtuese te saj, me perjashtim te rasteve qe rezervon neni 53(1) i Ligjit per shoqerite.

E DREJTA E NDALIMIT (LIEN)

16. Shoqeria ka te drejte kryesore pengimin (ndalimin) e cdo aksioni, per cfardo shume parash (direkt e pagueshme ose jo), per te cilen behet thirrje ose eshte e paguar ne nje kohe te caktuar. Shoqeria ka te drejte kryesore ndalimin e te gjitha aksioneve, te cilat jane te regjistruara ne emrin e nje personi te vetem, per cfardo shume parash, e paguar direkt nga ai ose nga pasuria e tij ne shoqeri. Keshilli Administrativ mundet qe, ne cdo kohe, te perjashtoje teresisht ose pjeserisht cdo aksion, sipas dispozitave te ketij statuti. E drejta e ndalimit, qe mund te kete shoqeria mbi nje aksion shtrihet ne te gjitha pjeset e pagueshme te tij (aksionit).

17. Shoqeria mundet te shese, gjithmone, sipas menyres se caktuar nga Keshilli Administrativ, cdo aksion, mbi te cilin ajo ka te drejten e ndalimit, por asnje shitje nuk duhet te kryhet, pervec se, nese nje pjese e shumes se tij, mbi te cilen ekziston e drejta e ndalimit, eshte direkt e pagueshme dhe ne kete rast vetem pas kalimit te 14 diteve nga dita e njoftimit me shkrim. Pagesa e kerkuar e pjeses si me lart duhet ti jepet, ne cdo rast, personit te regjistruar, zoterues i aksioneve dhe kjo pagese duhet bere per arsye vdekje ose falimentimi te zoteruesit te aksioneve.

18. Per cdo shitje te tille qe mund te realizohet, Keshilli Administrativ mundet te autorizojë nje person per transferimin e aksioneve te shitura tek bleresi i tyre. Bleresi duhet te regjistrohët si zoterues i aksioneve te perfshira ne kete transferim, por nuk ka asnje detyrim qe te interesohet per perdorimin e vleres se paguar te blerjes nga ai, nderkohe qe edhe titulli i tij mbi aksionet aspak nuk mund te ndikohet nga pavlefshmeria e procedures se zbatuar gjate shitjes.

19. E ardhura nga shitja derdhet ne shoqeri dhe destinohet per pagimin e pjeses se pagueshme direkt te shumes, ne vartesi nga e drejta e ndalimit, ndersa pjesa tjeter qe mund te mbetet duhet ti paguhet zoteruesit te aksioneve gjate dites se shitjes..

THIRRJA PER PAGESEN MBI AKSIONET

20. Ne cdo kohe, Keshilli Administrativ mund te therrase anetaret qe te kryejne pagesat e shumave financiare te pa shlyera per aksionet e tyre, te cilat, ne baze te kushteve te dhena per aksionet si me lart, nuk u likujduan ditën e caktuar per t'u paguar. Cdo anetar duhet t'i paguaje shoqerise, ne kohen dhe vendin e caktuar, shumen per te cilen u thirr (lajmerua) qe derdhe mbi aksionet e tij. Thirrja mund te revokohet ose anulohet, sipas vendimit te Keshillit Administrativ.

21. Thirrja konsiderohet e bere ne momentin e marrjes se thirrjes se autorizuar me vendim te Keshillit Administrativ. Mundet qe te caktohet edhe pagesa e shumes qe i perket thirrjes.

22. Zoteruesit e shumte te nje aksioni pergjigjen kolektivisht ose personalisht per pagesen e cdo shume, kur ata thirren per likujdimin e saj.

23. N.q.se shuma qe ka lidhje me thirrjen e bere, nuk paguhet para ose ditën e caktuar per pagim te kesaj shume, personi qe detyrohet per kete shume, duhet te paguaje kamate duke filluar nga data e caktuar per pagim deri ne datën qe do te kryhet pagesa. Perqindja e kamates caktohet nga Keshilli Administrativ, por ne asnje rast nuk duhet te kaloj mbi 8%. Megjithete, Keshilli Administrativ mundet te vendose per mos pagimin e nje kamate te tille, pas kerkeses se bere nga zoteruesi i aksioneve.

24. Cdo shume, e cila sipas kushteve te emetimit te nje aksioni, duhet te paguhet gjate dhenies te aksionit ose ne ditën e caktuar, qofte ndaj vleres nominative te aksionit qofte ndaj vleres se tij mbi te teren, konsiderohet si shume qe duhej paguar per thirrjen ne ditën e caktuar. Mos pagimi i kesaj shume ne ditën e caktuar, bazuar ne kerkesat e ketyre dispozitave, e detyron personin e thirrur te

paguaje kamaten e caktuar me perqindjen respektive. Keshilli Administrativ mundet, qe gjate emetimit te aksioneve, te beje ndarjen midis zoterueseve te aksioneve persa i perket shumes, te cilet, ne cdo kohe, do te thirren te bejne derdhjen e saj, Gjithashtu Keshilli Administrativ cakton edhe kohen e kryerjes se ketyre pagesave.

25. Keshilli Administrativ, mundet qe, me pelqimin e tij, te pranoje pagesen nga cdo anetar, duke percaktuar qe ai te parapaguaje teresisht ose pjeserisht shumate e papaguar per aksionet e zoteruara, per te cilat nuk ishte thirrur akoma nga shoqeria per t'i paguar, por gjithmone per cdo pjese te papaguar ne kete rast, mundet qe Keshilli Administrativ te vere kamate, qe nuk duhet te jete me e madhe se 5% ne vit.

TRANSFERIM I ZAKONSHEM I AKSIONEVE

26. Akti i transferimit te cdo aksioni kryhet nga ose ne emer te transferuesit ose agjentit, nderkohe qe transferuesi konsiderohet mbetes zoterues i aksionit deri sa emri i agjentit te regjistrohet ne Regjistrin Anetareve per aksionin e transferuar.

27. Gjithmone, nen rezervimin e kufizimeve te tilla te ketyre dispozitave, anetaret mund te transferojne te gjitha ose nje pjese te aksioneve te tyre nepermjet aktit te transferimit, te tipit te zakonshem ose te pergjithshem ose te cdo tipi tjeter, por gjithmone sipas tipit te miratuar nga Keshilli Administrativ.

28. Keshilli Administrativ mund te refuzoje qe te regjistroje transferimin e aksionit ne emer te personit, i cili nuk deshironte miratimin e tij, por mundet gjithashtu, qe te refuzoje te regjistroje edhe transferimin e aksionit, per te cilin shoqeria ka te drejte ndalimi.

29. Gjithashtu, Keshilli Administrativ mundet te refuzojete te njohe cdo akt transferimi, pervec rasteve kur:

a) Depozitohet ne shoqeri taksa prej 121/2 sent ose shume me e vogel se kjo, gjithmone sipas kerkeses te Keshillit Administrativ.

b) Akti i transferimit shoqerohet nga certifikata e aksioneve dhe nga te dhenat e tjera, gjithmone sipas kerkeses te Keshillit Administrativ.

c) Akti i transferimit i perket vetem nje klase aksionesh.

30. Ne rastin kur Keshilli Administrativ vendos refuzimin e regjistrimit te cdo transferimi, duhet qe brenda 2 muajeve nga data e depozitimit te aktit, shoqeria te njoftoje agjentin ne lidhje me nje vendim te tille te Keshillit Administrativ.

31. Regjistrimi i transferimit mundet te pezullohet ne ate kohe dhe ato periudha kur vendos Keshilli Administrativ, duke presupozuar, ne cdo rast, se nje regjistrim i tille nuk mund te pezullohet kur kalon 30 dite.

32. Shoqeria ka te drejte te vendose takse jo me te madhe se 25 sent per cdo regjistrim testamenti, akti emerimi administratori, certifikate vdekje ose martese, prokure ose akti tjeter.

33. Dispozitat 26 dhe 27 duhet te lexohen duke patur parasysh parashikimet e dispozites 34.

34.a) Ne zbatim te kesaj dispozite, sa here qe nje person ka te drejten absolute qe te regjistrohet si zoterues i aksionit, ai konsidrohesh anetar i shoqerise ne raport me aksionin qe zoteron.

b) Pervec aksioneve te perfshira me poshte, asnje aksion i shoqerise nuk duhet te transferohet.

c) Cdo anetar, i cili deshiron te transferoje cdo aksion ose te gjitha aksionet (i cili me poshte do te quhet "shites") duhet te njoftoje me shkrim shoqerine per kete transferim. Ne zbatim te dispozitave te meposhtme, njoftimi i transferimit e ben shoqerine perfaqesuese te Shitesit per shitjen e aksioneve te percaktuara ne njoftimin e transferimit.

d) Ne rastin kur nga konhtrollori kerkohet qe te vertetoje cmimin, shoqeria duhet qe, nga data e marrjes se vertetimit te kontrollorit, te pajise shitesin me kopjen e vertetimit, nderkohe qe shitesi ka te drejte qe me dokumentin e njoftimit, te dhene nga shoqeria, brenda 10 diteve, te anulloje autorizimin e dhene nga shoqeria per shitjen e aksinove te permenduara me lart. Shpenzimet e dhenies se vertetimit (certifikates) rendojne shoqerine, pervec rastit kur shitesi, nepermjet ketij njoftimi, anulon autorizimin e dhene nga shoqeria dhe shpenzimet ne kete rast rendojne shitesin.

e) Pas caktimit te cmimit dhe duke presupozuar se shitesi nuk deshiron te anulloje autorizimin e dhene nga shoqeria, sipas dispozitave te mesiperme, shoqeria njofton menjehere nepermjet lajmerit me shkrim cdo anetar te saj, pervec shitesit dhe zoterueseve te aksioneve-anetareve nenpunes, per numerin dhe cmimin e aksioneve te permenduara me siper si dhe fton cdo anetar qe te deklaraje me shkrim ne shoqeri, brenda 21 diteve nga data e dhenies se autorizimit numerin maksimal te aksioneve, (te gjitha numerin e aksioneve ose cdo numer tjeter te tyre) qe secili anetar deshiron te shese.

f) Ne rastin kur anetaret e deklaruar prononcohen brenda afatit te mesiperm prej 21 ditesh per te gjithë numerin e aksioneve ose per cdo numer tjeter te aksioneve te deklaruar, Keshilli Administrativ vendos per dhenien e aksioneve te deklaruar tek kerkuesit, ne kohen dhe vendin e caktuar, te cilet kane te drejte te regjistrohesh si zoterues te aksioneve te deklaruar.

g) Shitesi detyrohet te transferoje aksionet e deklaruar tek bleresit e percaktuar ne njoftimin e transferimit , ne kohen dhe vendin e duhur. N.q.se ky nuk e kryen nje veprim te tille, presidenti i shoqerise ose nje person tjeter i caktuar nga Keshilli Administrativ per kete qellim, konsiderohet perfaqesues i ligjshem i shitesit, i cili ka kopetence te plote per transferimin ne emer dhe per llogari te shitesit te aksioneve tek bleresi, kundrejt pagimit te vleres tek shoqeria. Pas derdhjes se vleres tek shoqeria, bleresi konsiderohet se ka plotesuar plotesisht detyrimet e blerjes dhe pas kryerjes se transferimit ai ka te dejte te kerkoje regjistrimin e tij ne Regjistrin e Anetareve si zoterues, nepermjet transferimit, te aksioneve te blera. Shoqeria, pa vonese, kryen derdhjen e vleres se aksioneve ne nje llogari te vecante bankare ne emer te shoqerise dhe kete vlere e zoteron shitesi.

gj) Shitesi ka te drejte qe, ne cdo kohe, brenda 6 muajeve nga dita e mbarimit te afatit te deklaruar prej 21 ditesh te permendur ne paragrafin (e) te kesaj dispozite, te transferoje tek cdo person dhe kundrejt cfardo cmimi cdo aksion te deklaruar ne njoftimin e dhenies. Shitesi ka te drejte, te kryeje shitjen e atyre aksioneve, te cilat jane te deklaruar ne njoftimin e transferimit te bere prej tij.

h) Cdo anetar ka te drejte qe te transferoje cdo aksion te tij per bashkeshortin (bashkeshorten), femijen, prinderit, vellain ose motren. Aksionet e anetarit te vdekur nuk mund te transferohen nga perfaqesuesit personale te tij tek bashkeshorti (bashkeshortja), femija, prinderit, vellai ose motra e tij. Aksionet e ndodhura ne emer te administratoreve te pasurise se anetarit te vdekur, mund te transferohen, ne rastin e nderrimit te administratoreve, ne cdo kohe tek administratoret e kesaj pasurie. Ne rastin kur anetari i shoqerise eshte person juridik, mundet qe te transferoj aksionet e tij tek cdo shoqeri e varur ose e komanduar prej tij. Kerkesat e dispozites 28 per transferimin e aksioneve duhet te zbatohen duke patur parasysh dispozitat e kesaj dispozite,

TRANSFERIMET E AKSIONEVE PER SHKAK VDEKJEJE OSE
FALIMENTIMI

35. Ne rast vdekjeje te anetarit te shoqerise, personi ose personat e gjalle, ne rastin kur anetari i vdekur ishte zoterues i aksioneve bashkarisht me nje ose me shume persoana, dhe perfaqesuesit e ligjshem persoanale te anetarit te vdekur, kur ai ishte zoterues i vetem i aksioneve, jane personat e vetem, te cilet duhet te njihen nga shoqeria si persona qe kane te drejte mbi interesin e tij.

36. Nje person, i cili kerkon te fitoje te drejten mbi aksionet e nje anetari te shoqerise qe vdes ose falimenton, mundet qe, duke paraqitur dokumentat, sipas kerkeses se Keshillit Administrativ dhe ne zbatim te kerkeseve te dispozitave te meposhtme, te zgjedhe ose te regjistrohet personalisht si zoterues i aksioneve ose te sugjeroje nje prson qe te regjistrohet si agjent i ketyre aksioneve, ne rast te kundert Keshilli Administrativ ka te drejten e refuzimit ose anulimit te regjistrimit, sikurse kete te drejte e ka edhe ne rastin e transferimit te zakonshem te aksioneve te kryer nga anetaret e shoqerise para vdekjes ose ne rastin e falimentimit te tij.

37. Ne rast se personi zgjedh variantin per t'u regjistruar personalisht, ai duhet ti paraqese shoqerise njoftimin me shkrim, te nenshkuar prej tij. Ne rastin kur ai sugjeron person tjeter per regjistrim, ai duhet te shprehet rreth vendimit te tij nepermjet kryerjes se akteve te kerkuara per transferimin e zakonshem te aksioneve tek personi i sugjeruar. Te gjitha kufizimet, ndalimet dhe parashikimet e ketyre dispozitave, te cilat i perkasin te drejtes per transferimin e zakonshem te aksioneve si dhe regjistrimit te transferimeve te kryera do te mund te zbatohen sikur vdekja ose falimentimi i anetarit te shoqerise nuk kishte ndodhur dhe transferimi ne kete rast quhet i zakonshem, i nenshkuar nga anetari sic theksohet me lart.

38. Cdo person, i cili kerkon te fitoje te drejten mbi aksionet e zoteruesit qe vdes ose falimenton, e fiton kete te drejte, persa i perket fitimit ose cdo interesi tjeter, sikur te ishte zoterues i regjistruar i aksioneve, por n.q.se para regjitrimit si anetar i shoqerise, ai nuk ka asnje te drejte qe rrjedh nga cilesia e anetarit te shoqerise. Eshte e kuptueshme se Keshilli Administrativ mundet qe, ne cdo kohe, te therrase cdo person te tille, per te zgjedhur ose regjistrimin personal ose te tranasferoje aksionet, pas afatit te kaluar prej 90 ditesh. Keshilli Administrativ mundet te pezulloje pagimin e cdo kuponi, cdo bono-je ose shume tjeter parash, e pagueshme

ne raport me aksionet, deri ne zbatimin e te gjitha kushteve te vendosura.

SEKUESTRIMET E AKSIONEVE

39. Ne rast se nje anetar i shoqerise nuk kryen pagimin e shumes se caktuar ne raport me vleren e aksioneve te zoteruara prej tij ose kestet e kesaj shume ne diten e caktuar, Keshilli Administrativ mundet, qe ne cdo kohe pas kesaj date, ti dergoje anetarit te shoqerise njoftimin per shlyerjen e shumes ose kesteve te papaguara bashke me kamatvonesat.

40. Njoftimi duhet te percaktoje daten kur duhet te kryhet pagesa .Ne rast mos pagimi te shumes se kerkuar ne kohen e caktuar, aksionet ,per te cilat eshte bere njoftimi, do ti nenshtrohen sekuestrimit.

41. Ne rast se anetari i shoqerise nuk bindet me kushtet e percaktuara ne njoftimin e bere si me lart, aksionet e permendura ne njoftim, mundet qe ne cdo kohe pas dates se caktuar, te sekuestrohen me vendim te Keshillit Administrativ.

42. Aksionet e sekuestruara mundet te shiten ose ndryshe te disponohen me kushtet dhe menyren qe vendos Keshilli Administrativ me pelqimin e tij. Ne cdo kohe, para kryerjes se shitjes se aksioneve ose disponimit te tyre, Keshilli Administrativ mundet te shfuqizojë vendimin per sekuestrimin e tyre.

43. Sekuestrimi i aksioneve sjell si pasoje humbjen e cilesise se anetarit mbi aksionet e sekuestruara, por ne asnje menyre nuk sjell heqjen e detyrimit te personit, te cilit ju sekuestruan aksionet, qe te paguaje ne shoqeri cdo shume, qe ai eshte i detyruar ne raport me aksionet e tij.

44. Deklara me shkrim, e bere ne baze te ligjit, se deklaruesi eshte anetar i Keshillit Administrativ ose sekretar i shoqerise dhe se aksionet e shoerise u sekuestruan sic duhet ne daten e caktuar, perben deshmi te pakontestueshme te fakteve te parashtruara ne kete deklarate, ndaj cdo personi, i cili kerkon te drejta mbi keto aksione. Shoqeria mundet te pranoje kunderpagesen e mundeshme te dhene per shitjen ose disponimin e aksioneve dhe si pasoje te transferoje aksionet tek personi qe ajo i shiti, i cili regjistrohet si zoterues i aksioneve dhe titulli i tij (dokumenti i pronesise) mbi aksionet nuk ndikohet aspak nga parregullsia ose pavlefshmeria e procedures se zbatuar gjate sekuestrimit, shitjes ose disponimit te aksioneve.

45. Parashimet e ketyre dispozitave ne lidhje me sekuestrimin mund te zbatohen edhe ne rastin kur nuk paguhet ne kohen e duhur cdo shume e caktuar per t`u paguar

nga emetimi i aksioneve, qofet ne raport me vleren nominative te aksionit qofte ne raport me vleren e aksionit ndaj te teres.

TRANSORMIMI I AKSIONEVE NE KAPITAL (STOCK)

46. Shoqeria mundet, nepermjet vendimeve te zakonshme te saj, te transformoje aksionet e likujduara ne kapital (stock) dhe perseri kapitalin (stock) ne aksione te cdo vlere.

47. Zoteruesit e kapitalit (stock) mundet qe te transferojne kapitalin ose cdo pjese te tij me ate menyre dhe sipas atyre dispozitave te aksioneve, prej te cilave erdhi kapitali (stock). Mundet, gjithashtu, para transformimit te tyre, qe aksionet te transferohen ose sipas menyres me te perafert, Keshilli Administrativ do te percaktoje kufirin minimal te transferimit te kapitalit (stock). Presupozohet se kufiri minimal nuk duhet te kaloje vleren nominale te aksioneve, prej te cilave rezultoi kapitali.

48. Zoteruesit e kapitalit kane, ne raport me kuoten e zoteruar prej tyre ne kapital, ato te drejta, privilegje dhe interesa ne lidhje me kuponet, te drejten e votes ne mbledhjet e Asamblese se shoqerise dhe ceshtje te tjera, njesoj sikurse ata kishin kur ishin zoterues te aksioneve, prej te cilave rezultoi kapitali (stock), por asnje privilegj dhe interes nuk duhet te jepet nga cdo shume e kapitalit, e cila n.q.se do te ishte ne formen e aksioneve, nuk do te ofronte kete privilegj ose interes.

49. Dispozitat e statutit te shoqerise, te cilat zbatohen per aksionet e likujduara, duhet te zbatohen edhe per kapitalin (stock) dhe fjalet e perdorura si «aksion» dhe «zoterues i aksionit» duhet te interpretohen si fjalet «kapital» dhe «zoterues i kapitalit».

TRANSFERIMI I KAPITALIT

50. Ne cdo kohe shoqeria mundet qe, nepermjet vendimeve te saj te zakonshme, te rrite kapitalin e saj, ne masen qe jo deshiron vete. Ne te njejtin vendim caktohet edhe vlere e aksioneve, ne te cilat ndahet shuma e mesiperme.

51. Shoqeria, mundet qe, me ane te vendimeve te zakonshme :

a) Te bashkoje kapitalin e saj dhe ta ndaje te gjithë ose nje pjese te tij ne aksione me te medha nga aksionet ekzistuese.

b) Te ndaje aksionet ekzistuese ose cdonjerin prej tyre ne aksione me vlere me te vogel nga ajo e caktuar ne Aktin e Themelimit, por gjithmone sipas dispozitave te neit 60

(1) (d) te Ligjit per Shoqerite.

c) Te shfuqizoje cdo aksion, per te cilin, gjate dates qe duhej te merrej vendimi, nuk u arrit asnje marrveshje.

52. Shoqeria mundet, me ane te vendimit te vecante, te paksoje kapitalin e saj, cdo fond rezerve te caktuar per likujdim, cdo rezerve tjeter nga emetimi i aksioneve mbi te teren, sipas menyre te percaktuar ne dispozitat e Ligjit per shoqerite si dhe sipas kushteve dhe kerkesave te ketij Statuti.

ASAMBLETE E PERGJITHSHME

53. Shoqeria therrret gjate vitit, pervec ndonje mbledhje tjeter, e cila duhej thirrur gjate ketij viti, Asamblene e Pergjithshme. Asamblea e pergjithshme vjetore thirret nepermjet lajmerimit te bere nga shoqeria. Intervali kohor midis dates se mbledhjes te nje Asambleje te Pergjithshme vjetore me daten e Asamblese se ardhshme vjetore nuk duhet te kaloje mbi 15 muaj.

Kuptohet qe, ne rast se shoqeria duhej te therriste mbledhjen e pare te saj te Asamblese se Pergjithshme brenda 18 muajeve nga dita e themelimit te saj, nuk imponohet mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te shoqerise brenda vitit te themelimit te saj ose te vitit te ardhshem.

Asamblea e Pergjithshme vjetore thirret ne kohen dhe vendin e caktuar nga Keshilli Administrativ.

54. Te gjitha Asamblete e Pergjithshme, pervec atyre vjetore, quhen Asamble te Pergjithshme te Jashtezakonshme.

55. Keshilli Administrativ miundet, kur ai e gjykon te nevojshme, te therrase Asamblene e Pergjithshme te Jashtezakonshme. Asamblete e Pergjithshme te Jashtezakonshme thirren me kerkese te Keshillit Administrativ dhe ne rast se Keshilli Administrativ nuk e kryen nje akt te tille, Asamblea e Pergjithshme e Jashtezakonshme thirret nga ata persona-kerkues, sic e parashikon neni 126 i Ligjit per shoqerite. N.q. se ne cdo kohe, nuk ndodhet ne Qipro numri i kerkuar per formimin e perberjes te Keshillit Administrativ ,2 nga anetaret e shoqerise mund te therrasin Asamblene e Pergjithshme te Jashtezakonshme sipas menyres qe mund ta therriste Keshilli Administrativ aso me nje menyre tjeter te perafert.

LAJMERIMI PER THIRRJEN E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

56. Asambleja e Pergjithshme vjetore si dhe cdo Asamble e mbledhur per marrjen e vendimeve te vecanta, thirret me ane te lajmerimit me shkrim te pakten 21 dite perpara, ndersa Asamblete e tjera, po me lajmerim me shkrim, por te pakten 14 dite perpara. Ne afatet e mesiperme, ne asnje rast nuk perfshihet dita dite e dorezimit te lajmerimit dhe dita, ne te cilen do te zhvillohet mbledhja e Asamblese, te ciles i perket lajmerimi. Ne lajmerim percaktohet vendi, dita dhe ora e zhvillimit te mbledhjes te Asamblese dhe ne rast te diskutimit te ndonje teme te vecante edhe natyre e kesaj teme (ceshtje). Lajmerimi behet sipas menyrave te meposhtme , te caktuar nga shoqeria ne Asamblene e Pergjithshme dhe i dorezohet atyre personave, te cilet ne baze te dispozitave te ketij Statuti, kane te drejte t'ju dorezohet ky lajmerim.

Kuptohet se, Asamblete e shoqerise, te thirrura me lajmerim brenda nje afati me te shkurter nga sa prcaktohet ne kete dispozite, konsiderohen te rregullta, kur per kete jane dakort:

- (a) Te gjitha anetaret e shoqerise ne rastin e thirrjes se Asamblese se Pergjithshme vjetore, te cilet kane te drejte te marrin pjese dhe te votojne ne te.
- (b) Kur ne cdo rast tjeter, shumica e numerit te anetareve, te cilet kane te drejte te marrin pjese te votojne ne Asamble dhe perkete, bashkarisht zoterojne jo me pak se 95% te vleres nomonative te aksioneve te dhena.

57. Mos dorezimi i lajmerimit per thirrjen e cdo Asambleje te shoqerise ose mos marrja e mundeshme e tij nga ana e anetarit te shoqerise, nuk mbart anulimin e zhvillimit te Asamblese, te ciles i perket lajmerimi.

PROCEDURA NE ASAMBLETE E PERGJITHSHME

58. Te gjitha ceshtjet e diskutuara ne Asamblete e Jashtezakonshme dhe ne Asamblene e Pergjithshme vjetore, me perjashtim te ceshtjeve per caktimin e kuponeve, shqyrtimit te llogarive, te bilanceve, te raporteve te Keshillit Administrativ, te emerimit te kontrolloreve (revizoreve) si dhe te caktimit te shperblimit te tyre, konsiderohen ceshtje te natyres se vvecante.

59. Asnje ceshtje nuk duhet te diskutohet ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, n.q.se nuk sigurohet numeri i mjaftueshem ne momentin e fillimit te punimeve te Asamblese. Nese nuk parashikohet ndryshe ne kete Statut, pjesmarrja konsiderohet e mjaftueshme per fillimin e mbledhjes, kur antaret qe marrin pjese ne te, personalisht ose me perfaqesues, zoterojne 51 % te aksioneve te shoqerise.

60. N.q.se brenda 30 minutave nga koha e caktuar per zhvillimin e mbledhjes nuk sigurohet pjesmarrja e mjaftueshme, aAsambleja, perderisa ajo eshte thirrur me kerkese te anetareve, shperndahet. Ne cdo rast tjetër ajo shtyhet per te njejetn dite te javes se ardhshme, te njeten ore dhe vend ose per cdo dite tjetër, ore dhe vend qe vendos Keshilli Administrativ. N.q.se edhe heren e dyte nuk sigurohet pjesmarrja e mjaftueshme brenda 30 minutave nga koha e caktuar per zhvillimin e mbledhjes te Asamblese, atehere antaret presen konsederohen se perbejne pjesmarrjen e mjaftueshme per fillimin e mbledhjes.

61.N.q.se ka kryetar te Keshillit Administrativ, ai drejton cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise, por n.q.se ky mungon ose nuk vjen brenda 15 minutave nga koha e caktuar per fillimin e mbledhjes ose nuk pranon te drejtoje mbledhjen, antaret e Keshillit Administrativ zgjedhin nga gjiri i tyre nje antar per ta drejtuar ate.

62. N.q.se ne ndonje mbledhje te Asamblese, asnje nga antaret e Keshillit Administrativ nuk deshiron ta drejtoje ate ose asnjeri prej tyre nuk vjen brenda 15 minutave nga koha e caktuar per fillimin e mbledhjes, atehere antaret presend te shoqerise zgjedhin nja antar nga gjiri i tyre per ta drejtuar ate.

63. Me pelqimin e pjesmarresve ne mbledhjen e Asamblese, kryetari i zgjedhur me mandatin e saj, eshte i detyruar qe te anulloje ne cdo kohe mbledhjen e Asamblese dhe te caktoje nje kohe dhe vend tjetër per zhvillimin e saj, por me kusht qe ne mbledhjen e ardhshme te mos diskutohet dhe shqyrtohet asnje ceshtje tjetër, pervec atyre te rendit te dites se mbledhjes se shtyre.Ne rast se mbledhja e Asamblese shtyhet per nje periudhe prej 30 ose dhe me shume ditesh, duhet qe per mbledhjen e shtyre te behet lajmerim, sikurse u be edhe per mbledhjen e pare. Me perjashtim te rasteve te mesiperme, per snje shtyrje tjetër te mbledhjes se Asamblese nuk eshte i detyrueshem lajmerimi per zhvillimin dhe rendin e dites se saj.

64.Rezolutat ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme miratohen me ngritjen e dores, pervec rasteve kur miratimin e tyre nepermjet votimit te fshehte e kerkon :

(a) Kryetari i mbledhjes se Asamblese.

(b) Te pakten dy antare, qe marrin pjese personalisht ose nepermjet perfaqesuesit te tyre.

(c) Cdo antar ose disa antare qe marrin pjese personalisht ose nepermjet perfaqesueseve te tyre dhe qe perfaqesojne te pakten 1/10 e numerit te pergjithshem te antareve qe kane te drejten e votes ne Asamble.

(d) Cdo antar ose disa antare zoterues te aksioneve te shoqerise me te drejte vote ne Asamble, qe kane paguar nje kote te barabarte me te pakten 1/10 e shumes se pergjithshme te aksioneve.

Pervec rastit, per te cilin kryhet votim i fshehte, deklarimi i kryetarit per miratimin ose jo te rezolutes me ane te votimit me ngritjen e dores dhe regjistrimi perkates ne Librin e Protokolleve te Shoqaerise, perben fakt te pakontestueshem persa i perket numerit ose perqindjes te votave pro/kunder ne lidhje me rezoluten e votuar.

Kerkesa per kryerjen e votimit te fshehte mund te revokohet.

65. Me perjashtim te rasteve qe parashikon dispozita 68, ne rastet e tjera kur kerkohet zhvillimi i votimit te fshehte, ky zhvillohet sipas menyres qe percakton kryetari i mbledhjes, ndersa rezultati i tij konsiderohet njesoj si vendimi i Asamblese, per te cilin eshte kerkuar zhvillimi i votimit te fshehte.

66. Ne rast te rezultatit te barabarte te votav ne procesin e votimit te kryer ose me ngritjen e dores ose ne menyre te fshehte, kryetari i mbledhjes nuk ka te drejte per vote te dyte.

67. Votimi i fshehte per zgjedhjen e kryetarit ose per anullimin e Asamblese kryhet pa vonese. Votimi i fshehte, i kerkuar per cdo ceshtje tjetere, zhvillohet ne cdo kohe qe caktohet nga kryetari i mbledhjes, ndersa cdo ceshtje tjetere, vec asaj qe kerkon votim te fshehte, mund te vazhdoje te diskutohet para ose pas votimit te fshehte.

VOTA E ANTAREVE

68. Duke rezervuar te drejtat dhe kufizimet e aksioneve te cdo klase (kategorie), cdo antar qe merr pjese personalisht ne votim me ngritjen e dores, ka nje vote, ndersa gjate votimit te fshehte ka nje vote per cdo aksion shuma e aksioneve te zoteruar prej tij.

69. Kur aksioni zoterohet bashkarisht prej me shume se nje personi, pranohet vota e personit me te vjeter, qofte kur ky voton personalisht, qofte nepermjet perfaqsesit te tij, duke perjashtuar votat e te tjereve.. Vjetersia ne kete rast percaktohet nga radha e reshtimit te emrave ne ReAntareve.

70. Nje anetar qe eshte i paafte intelektualisht dhe per te cilin jepet vendim nga Gjykata sipas procedures per personat e semure menderisht, mundet te votoje, si gjate votimit me ngritjen e dores ashtu edhe ne votimin e fshehte nepermjet administruesit te pasurise se tij, kujdestareve dhe mbikqyresve te tij ose nepermjet te cdo personi tjetere me cilesi te ngjashme, i caktuar nga kjo Gjykate. Kur behet fjale per

votim te fshehte personat ne fjale te antarit te paafte intelektualisht, mund te perfaqesohen nga nje perfaqesues i autorizuar.

71. Asnje antar nuk mund te votoje ne Asamblete e Pergjithshme, n.q.se nuk nuk ka paguar kuoten e caktuar ne proporcion me aksionet e zoteruar prej tij ne shoqeri ose cdo kuote tjeter e detyruar per t'u paguar prej tij ne raport me aksionet e zoteruara.

72. Asnje reklamim , ne lidhje me te drejten e votes te cdo personi nuk mund te behet, pervecse gjate mbledhjes se Asamblese , ne te cilen jepet ose ofrohet kjo vote ne lidhje me reklamimin. Ndersa vota, e cila nuk duhet te ndalohet ne nje mbledhje te tille, konsiderohet e vlefshme. Cdo reklamim i tille, i bere ne kohen e duhur i percillet Kryetarit te Asamblese, vendimi i te cilit eshte i formes se prere.

73. Ne rast te votimit te fshehte, antaret mund te votojne ose personalisht ose nepermjet perfaqesuesit te tyre.

74. Akti i emerimit te perfaqesuesit te autorizuar mban nenshkrimin e antarit te antarit qe ben emerimin dhe te perfaqesuesit te autorizuar me shkrim dhe ne rast se personi qe ben emerimin eshte person juridik, akti duhet te mbaje vulen e personit juridik, nenshkrimin e nenpunesit te autorizuar ose perfaqesuesit te tij.

Perfaqesuesi i autorizuar nuk eshte domosdoshmeri te jete antar i shoqerise.

75. Akti i emerimit te perfaqesuesit te autorizuar dhe cdo akt tjeter i mundshem autorizimi, me ane te nje kopje te legalizuar te tyre duhet te depozitohen ne Zyren e Regjistrimit te shoqerise ose tek cdo Autoritet tjeter kopetent ne Qipro, qe cilesohen ne lajmerimin per thirrjen e mbledhjes se Asamblese, ne cdo moment para kohes se caktuar te mbledhjes se Asamblese ose date te shtyre te saj.

76. Akti i emerimit te perfaqesuesit te autorizuar duhet te perpilohet sipas tipit te meposhtem:

.....LIMITED

Une/Ne, antar/antare te shoqerise se mesiperme, me ane te ketij akti emerohet/emerojme si perfaqesues te autorizuar tim/tone z..... ose ne pamundesi te tij, z. qe ne emrin tim/tone te votoje ne vendin tim/tone gjate(vjetore ose e jashtezakonshme, sipas rastit) Asamblese se Shoqerise, e cila do te thirret me dt....., muajiviti..... ose ne cdo date tjeter te shtyre te saj.

U nenshkrua me dt....., muaji..... viti.....

77. Per rastet kur qellimi i emerimit te perfaqesuesit te autorizuar eshte qe ti jape antareve mundesine qe te votojne « pro » ose « kunder » nje rezolute, akti i emerimit te perfaqesuesit te autorizuar duhet te jete sipas tipit :

.....LIMITED

Une/Ne, antar/antare te shoqerise se mesiperme, me ane te ketij akti emerij/emerojme si perfaqesues te autorizuar tim/tone z..... ose ne pamundesi te tij, z. qe ne emrin tim/tone te votoje ne vendin tim/tone gjate(vjetore ose e jashtezakonshme, sipas rastit) Asamblese se Shoqerise, e cila do te thirret me dt....., muajiviti..... ose ne cdo date tjeter te shtyre te saj.

U nenshkrua me dt....., muaji..... viti.....

Ky tim i aktit te emerimit duhet te perdoret pro/kunder rezolutes.

Pervec rastit, sipas te cilit duhet qe perfaqesuesit ti jepen udhezime te vecanta, perfaqesuesi i autorizuar voton sipas gjykimit te tij.

78. Akti i emerimit te perfaqesuesit te autorizuar konsiderohet se i jep atij kopetencen qe te kerkoje kryerjen e votimit te fshehte ose te marre pjese ne te mbi bazen e kerkeses se paraqitur.

79. Vota e dhene sipas kushteve te aktit te emerimit, konsiderohet e vlefshme edhe n.q.se me pare ka ndodhur vdekja ose paaftesia intelektuale e personit qe ben emerimin.

80. Duke zbatuar dispozitat e Ligjit per shoqerite, vendimi me shkrim, qe mban nenshkrimin e te gjitha antareve, te cilet kane te drejte qe t'u dergohet lajmerim per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, qe te marrin pjese ne te dhe votojne eshte i vlefshem dhe ka ato efekte ligjore sikur ai te ishte votuar ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

**PERFAQESUESIT JURIDIKE QE VEPROJNE ME ANE TE PERFAQESUESEVE
NE MBLEDHJET E ASAMBLEVE**

81. Cdo person juridik, antar i shoqerise, mundet qe nepermjet vendimit te Keshillit Administrativ ose Organi tjeter drejtues te autorizoj sipas gjykimit te tij nje person tjeter, qe ta perfaqesoje ate ne mbledhjet e Asamblese se Shoqerise, duke i dhen e atij te gjitha kopetencat qe personi juridik do te ushtronte, n.q.se do te ishte antar i shoqerise si person fizik.

KESHILLI ADMINISTRATIV

82. N.q.se shoqeria vendos ndryshe ne Asamblene e Pergjithshme, numeri i anetareve te Keshillit Administrativ nuk duhet te jete me pak se. Antaret e pare te

Keshillit Administrativ te shoqerise duhet te emerohen me shkrim nga nenshkruessit e Aktit Themelues ose nga shumica e tyre. Per kete rast nuk eshte e nevojshme thirrja e asnje Asambleje.

83. Shperblimi i anetareve te Keshillit Administrativ caktohet nga shoqerias ne Asamblene e Pergjithshme. Ky shperblim llogaritet me baze ditore. Anetareve te Keshillit Administrativ ju pagugen te gjitha djetat e nevojshme per udhetim, ushqim dhe hotel.

84. Kushti i zoterimit te aksioneve nga anetaret e Keshillit Administrativ mund te caktohet nga shoqeria ne Asamblene e Pergjithshme.

85. Anetaret e Keshillit Administrativ te shoqerise mundet te jene ose emerohen anetare te ketij Keshilli dhe kuadro te tjere ose te kene interesa ne shoqeri te tjera.

KOPETENCA PER LIDHJE KONTRATE KREDISH

86. Keshilli Administrativ mund te lushtroje te gjitha kopetencat per lidhjen e kontratave per marrje kredish finaciare.

KOPETENCAT DHE DETYRAT E ANTAREVE TE TIJ

87. Veprimtaria e shoqerise drejtohet nga Keshilli Administrativ, i cili mund te depozitoje per krijimin dhe regjistrimin e shoqerise cdo shume parash dhe te ushtroje te gjitha ato kopetenca, pervec atyre qe ne baze te Ligjit per shoerite dhe dispozitat e ketij Statuti duhet te ushtrohen nga shoqeria nepermjet Asamblese se Pergjithshme.

88. Keshilli Administrativ ne cdo kohe mund te emeroje nepermjet aktit te autorizimit, cdo shoqeri, perfaqesi ose person ose organizem, direkt ose indirekt, qe te veproje si perfaqesues i shoqerise, duke percaktuar qellimet e cilat do te veproje personi i autorizuar.

89. Shoqeria mundet te ushtroje kopetencat e dhena tek ajo ne baze te nenit 36 te Ligjit per shoerite ne lidhje me perdorimin e vules jashte shtetit, por keto kopetenca mund ti kalojne edhe Keshillit Administrativ.

90. Shoqeria mundet te ushtroje kopetencat e parashikuara ne nenet 114 dhe 117 te Ligjit per Shoerite persa i perket ruajtjes nga ana e saj, jashte selise se shoqerise, te Regjistrimit te anetareve, ndersa Keshilli Administrativ mundet, qe sipas gjykimit te tij, duke respektuar nenet e mesiperme te beje ndryshimin e dispozitave ne lidhje me ruajtjen e ketij Regjistri,

91. (1) Cdo anetar i Keshillit Administrativ, i cili ka cdo interes, direkt ose indirekt, ne kontrate me shoqerine, duhet te deklaroje natyren e interesit te tij ne mbledhjen e Keshillit Administrativ, sipas dispozitave te nenit 191 te Ligjit per Shoqerite.

(2) Anetaret e Keshillit Administrativ mund te votojne ne lidhje me cdo kontrate ose marreveshje, edhe n.q.se ka ndonje interes tek ajo. Perderisa ajo duhet te votohet, vota e tyre llogaritet dhe prania e tyre merret parasysh qe te gjendet, n.q.se sigurohet pjesmarrja ne cdo mbledhje te Keshillit Administrativ, para se ciles duhej shtruar per studim cdo kontrate e tille, kontrata ose marreveshja e synuar.

(3) Anetaret e Keshillit Administrativ mundet te zoterojne cdo post ose vend tjetër ne shoqeri kundrejt leverdise se fitimit (perjashtuar postin e kontrollorit) pervec cilsise se tyre te anetarit te Keshillit Administrativ, per nje perudhe te tille dhe me kushte te tilla, qe vendos Keshilli Administrativ ne cdo kohe. Cilesia e anetarit te Keshillit Administrativ nuk perben pengese per lidhjen e kontrates nga ana e tij me shoqerine ose per f sigurimin nga ana e tij te ndonje posti ose vendi tjetër me leverdi fitimi.

(4) Anetaret e Keshillit Administrativ mundet qe nen cilesine e tyre profesionale te kryejne, qofte vete personalisht, qofte nepermjet te perfaqesise qe i perket atij, per interes te shoqerise, kundrejt shperblimit, sherbime profesionale qe ju jane caktuar, sherbime te cilesise se tyre si anetare te Keshillit Administrativ, por ne asnje rast nuk mund te marrin persiper detyrat e kontrollorit (revizorit) te shoqerise.

92. Nenshkrimi, dhenia, pranimi, vertetimi ose cdo ekzekutim i kryer sipas rastit, me ceqe, kambiale dhe tituj te tjere si dhe cdo fature tjetër pagese parash ne shoqeri duhet te kryhet sipas menyres se vendosur nga Keshilli Administrativ, ne cdo rast.

93. Keshilli Administrativ duhet te tregojë kujdes per regjistrimin ne librat e ruajtura prej tij:

- a) Te cdo emerimi kuadri te kryer prej Keshillit Administrativ.
- b) Te emrave te anetareve pjesmarres ne cdo mbledhje te Keshillit Administrativ ose mbledhje te komisioneve te tij.
- c) Te vendimeve te marra dhe ceshtjeve te diskutuara ne Asdmablete e shoqerise, mbledhjet e Keshillit Administrativ dhe mbledhjet e komisioneve te tij.

PENSIONET

94. Keshilli Administrativ mund te jape pensione per plotesim vjetersise ne

pune, te ardhura vjetore, dhurata ose shperblime te tjera, perfshire edhe akordimet per shkak vdekje, per cdo person qe ka ofruar sherbimin e tij ne shoqeri, qofte me cilesine e keshilltarit drejtues ose kuadri e nenpunesi tjeter te shoqerise, qofte edhe indirekt me cilesine e kuadrit ose nenpunesit te cdo shoqerie tjeter te varur nga kjo shoqeri, edhe nese ka gene anetar i Keshillit Administrativ te shoqerise. Shoqeria mundet te kryeje edhe pagesat per sigurimin, trustet, programet dhe arkat per qellimet e mesiperme ne lidhje me cdo person. Ajo mundet te perfshije edhe te drejta ne lidhje me pensionet, te ardhurat dhe shperblimet e mesiperme ne kushtet e marrjes ne pune te cdo personi ne shoqeri.

RREZIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT ADMINISTRATIV

95. Vendi i cdo anetari te Keshillit Administrativ mbetet vakant ne rastet kur:

- a) Humb cilesine e tij, ne baze te nenit 176 te Ligjit per Shoqerite, ose
- b) Shpallet ne falimentim ose kalon ne sistemime ose bie ne kompromis me kreditoret e tij pergjithsisht, ose
- c) Priviohet nga e drejta per tu emeruar anetar i Keshillit Administrativ, bazuar ne dispozitat e nenit 180 te Ligjit per Shoqerite, ose
- d) Behet i paafte intelektualisht, ose
- e) Jep dorheqjen nga vendi i tij, nepermjet njoftimit me shkrim te shoqerise.

EMRIMI I KESHILLTAREVE TE TJERE ADMINISTRATIVEE.

PUSHIMI I KESHILLTAREVE ADMINISTRATIVE

96. Keshilli Administrativ ka kopetence qe ne cdo kohe te emeruje nje person si anetar te tij, si per plotesimin e ndonje vendi vakant, ashtu edhe mbi numerin e anetareve ekzistues te Keshillit Administrativ, duke patur parasysh qe numri i pergjithshem i anetareve te tij, ne asnje menyre nuk duhet te kaloje mbi ate qe percaktohet ne dispozitat e ketij statuti. Cdo anetar i emeruar i Keshillit Administrativ duhet te qendroje ne vendin e tij deri ne mbledhjen e radhes te Asamblese vjetore te pergjithshme, ku edhe mund te rizgjidhet.

97. Shoqeria mundet qe nepermjet nje vendimi te zakonshem, komunikuar sipas nenit 136 te Ligjit per Shoqerite, te pushoje cdo anetar te Keshillit Administrativ para mbarimit te mandatit te tij, pavaresisht nga ajo c'ka eshte arritur ne keto dispozita ose cdo marrveshje tjeter midis shoqerise dhe ketij anetari. Nje pushim i tille nuk ndikon aspak tek cdo kerkese per demshperblim, qe nje anetar i tille mund te kete, si pasoje e shkeljes se kushteve te kontrates se sherbimit te lidhur midis tij dhe shoqerise.

98.Shoqaria mundet qe ne cdo moment dhe kohe pas kohe(pa cenuar kopetencat e Keshillit Administrativ sipas dispozites 96) nepermjet nje vendimi te zakonshem te saj te emeruje cdo person si anetar te Keshillit Administrativ si dhe te percaktoje periudhen qe ky person i tille do te mbaje kete vend.

PROCEDURA NE MBLEDHJET E KESHILLIT ADMINISTRATIV

99.Keshilli Administrativ mundet te mblidhet per zhvillimin e punimeve te tij si dhe te anulloje ose ndryshe te rregulloje me pelqimin e tij ceshtjet e lindura, per te cilat vendoset me shumice votash ne mbledhjet e tij.Secili prej anetareve te Keshillit Administrativ mundet, nepermjet kerkeses te depozituar tek sekretari, te therrase ne cdo kohe mbledhjen e Keshillit Administrativ. Anetaret e Keshillit Administrativ, te cilet ndodhen jashte Qipros dhe qe kane njoftuar me shkrim shoqerine per adresen e tyre jashte Qipros, duhet te lajmerohen te pakten 96 ore para zhvillimit te mbledhjes se Keshillit Administrativ .Te gjitha mbledhjet e Keshillit Administrativ si dhe ato te Komisioneve te tij zhvillohen ne Qipro. Ketu kryhet edhe administrimi dhe kontrolli i veprimtarise se shoqerise.

100.Keshilli Administrativ mundet te caktoje per zhvillimin e punimeve te tij numerin e nevojshem te pjesmarrjes se anetareve per zhvillimin e mbledhjes dhe ne rast se nuk percaktohet nje pjesmarrje e tille e anetareve te tij, anetaret prezent personalisht ose nepermjet perfaqesueseve te tyre, perbejne numrin minimal te domosdoshem per zhvillimin e mbledhjes.

101.Anetaret ne veprim te Keshillit Administrativ mund te ushtrojne detyrat e tyre edhe n.q.se eshte bosh vendi i ndonjerit prej anetareve te tij. Por ne rast se numer i anetareve zvogelohet nen numerin e caktuar nga dispozitat e shoqerise, i domosdoshem per formimin e pjesmarrjes minimale, anetaret ne veprim, sipas rastit, mund te mbidhen vetem per te vendosur numerin e caktuar ose te veprojne per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme te shoqerise, por jo per ndonje qellim tjetër.

102. Keshilli Administrativ mund te zgjedhe kryetar te drejtimit te mbledhjeve te tij dhe te caktoje kohen qe ai do te qendroje ne kete post. Ne rast se nuk zgjidhet kryetar ose kryetari i zgjedhur nuk vjen ne mbledhje brenda 5 minutave nga koha e caktuar per zhvillimin e saj, anetaret prezent te Keshillit Administrativ mund te zgjedhin nga gjiri i ture drejtuesin e mbledhjes.

103.Keshilli Administrativ mund te delegoje (jape) kopetencat e tij tek komisioni ose komisionet, te perbera nga nje ose dhe me shume anetare te caktuar nga Keshilli Administrativ. Cdo komision duhet te bindet per ushtrimin e kopetencave te

dhena nga Keshilli Administrativ ne baze te dispozitave qe percaktojne kopetencat, strukturen, numrin etj.

104. Cdo komision duhet te zgjedhe kryetar te drejtimit te mbledhjeve te tij. N.q.se nuk zgjidhet i tille, ose kryetari zgjedhur nuk vjen brenda 5 minutave nga koha e caktuar per zhvillimin e mbledhjes, anetaret prezent te komisionit mund te zgjedhin nga gjiri i tyre drejtuesin e mbledhjes.

105. Ne zbatim te dispozitave te vena nga Keshilli Administrativ, komision mund te mblidhet ose anulloje mbledhjet, sipas pelqimit te tij, ndersa ceshtjet e lindura gjate zhvillimit te mbledhjes, vendosen me shumice votash te anetareve prezent.

106. Te gjitha aktet dhe veprimet e kryera nga mbledhja e Keshillit Administrativ, nga komisioni i tij ose nga cdo person me cilesine e anetarit te Keshillit Administrativ, jane te vlefshme, madje edhe nese me vone konstatohet se ne emerimin e ndonje anetari ka patur ndonje mangesi ose ndonjeri prej tyre nuk gezon cilesite e nevojshme per kryerjen e akteve dhe veprimeve si anetar i Keshillit Drejtues etj.

107. Vendimi me shkrim, i nenshkruar ose miratuar dhe i derguar me teletajp, telefaks ose telegram nga cdo anetar i Keshillit Administrativ ose zvendesi i tij, eshte i vlefshem dhe mbart efektet ligjore njesoj sikur ai te jete miratuar ne mbledhjen e Keshillit Administrativ. Kur behet fjale pder vendim me shkrim dhe ai mund te perbehet prej me shume se nje dokument, secili prej tyre duhet te mbaje nenshkrimin e njerit ose edhe te me shume personave te permendur si me lart.

ZVENDESUESIT E ANETAREVE TE KESHILLIT ADMINISTRATIV

108 (a) Cdo anetar i Keshillit Administrativ ka kopedencen qe ne cdo kohe te sugjeroje nje anetar tjeter te Keshillit Administrativ ose cdo person tjeter jo anetar te Keshillit Administrativ, qe te veproje si zvendesues i tij, por kete kopetence te vecante ai ka te drejte qe zvendesuesit te tij te sugjeruar t`ja heqe.

(b) Zvendesuesi i nje anetari te Keshillit Administrativ i nenshtrohet nga cdo pikpamje kushteve qe i nenshtrohe edhe anetaret e tjere te Keshillit Administrativ, nderkohe qe ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Keshillit Administrativ, nepermjet lajmerimit te bere, ku te diskutoje dhe votoje ne vend te anetarit qe ai zvendeson.

(c) Nje person mund te zvendesoje me shume se nje anetar te Keshillit Administrativ, por per sa kohe vepron si zvendesues i me shume se nje anetari, ai ka te drejten e votes se vecante per secilin anetar te Keshillit Administrativ.

(d) Emerimi ose pushimi i personit zvendesues te njerit prej anetareve te Keshillit Administrativ mund te kryhet nepermjet telegramit ose radiogramit ose me

cdo menyre tjeter te miratuar nga Keshilli Administrativ. Telegrami ose radiogrami duhet qe sa te jete e mundur me shpejt, te konfirmohet me ane te letres, nderkohe qe shoqeria mund te veproje mbi bazen e ketij telegrami dhe radiogrami.

(e) Menjehere,sapo anetari i Keshillit Administrativ te humbe cilesine e anetarit ose per arssyje te mbetjes bosh te vendit te tij ne mbledhjen e shoqerise, gjate se celes ai edhe rizgjidhet, personi i emeruar nga ai se zevendesues zhvishet nga te gjitha kopetencat dhe autorizimi per te vepruar si zevendesues i anetarit ne fjale.

f)Anetaret e Keshillit Administrativ asnje pergjegjesi nuk kane per veprimet ose mosveprimet e zevendesueseve te emeruar pej tyre.

g) Personi zevendesues i ndonjerit prej anetareve te Keshillit Administrativ ne asnje rast nuk merret ne konsiderate gjate llogaritjes te numerit te lejueshem minimal ose maksimal te Keshillit Administrativ, por merret ne konsiderate vetem me qellim per t'u llogaritur nense eksiston numeri minimal i pjesmarrjes ne mbledhjen e Keshillit Administrativ, ne te cilen merr pjese dhe ka t drejten e votes.

KESHILLTARI DREJTUES

109. Keshilli Administrativ ka te drejte te emeroje nje (1) ose me shume nga anetaret e tij si Keshilltar Drejtues, per nje periudhe dhe sipas kushteve qe ai vendos vete, por ne cdo kohe,duke zbatuar kushtet e marreveshjes se arritur, mundet te revokoje personin e emeruar prej tij.

110.Keshilltari Drejtues ka te drejte per shperblim (qofte ne formen e rroges ose pjesmarrjes ne fitime ose pjeserisht sipas njeres forme dhe pjeserisht sipas formes tjeter), sipas menyres qe do te vendose cdo here Keshilli Administrativ.

111.Keshilli Administrativ mund ti caktoje ose jape Keshilltarity Drejtues cdo kopetence te ushtruar prej tij, duke ju bashkengjitur ketyre kopetencave kushtet dhe kufizimet e caktuara prej Keshillit Administrativ. Kopetencat e dhena mund te ushtrohen ose paralelisht me Keshillin Administrativ ose krejtesisht vetem nga Keshilltari Drejtues i Keshillit Administrati. Ne cdo kohe te gjitha kopetencat e dhena tek Keshilltari Drejtues mund te revokohen, pezullohen ose ndryshohen nga Keshilli Administrativ.

SEKRETARI

112. Sekretari emerohet nga Keshilli Administrativ, i cili sipas pelqimit te tij, i cakton atij kohen, shperblimin dhe kushtet e tjera, Keshilli Administrativ, ne cdo kohe mund te pushoje sekretarin e emeruar prej tij.

113. Asnje person nuk duhet emeruar ose zere vendin e sekretarit, pedrderisa ai eshte:

(a) Anetar i vetem i Keshillit Administrativ.

(b) Person juridik, i cili eshte edhe anetar i vetem i Keshillit Administrativ te ketij personi juridik, edhe anetar i vetem i Keshillit Administrativ te shoqerise.

(c) Anetar i vetem i Keshillit Administrativ te ndonje personi juridik, i cili eshte anetar i vetem i Keshillit Administrativ te shoqerise.

114. Ne rast se, sipas dispozitave te Ligjit per shoqerite dhe dispozitave te ketij Statuti, vula, e cila perdoret vetem me autorizim te Keshillit Administrativ per akte te kryera nga Anetari i Keshillit Administrativ dhe Sekretari ose nga persona te autorizuar prej tyre, keto akte (veprime) nuk konsiderohen te rregullta, perderisa ato kryhen nga nje person, i cili kryen edhe detyren e anetarit te Keshillit Administrativ edhe detyren e Sekretarit, ose zevendeson sekretarin.

VULA

115. Keshilli Administrativ duhet te kujdeset per ruajtjen e sigurte te vules, e cila perdoret vetem me autorizim te Keshillit Administrativ ose te Komisionit te tij. Cdo dokument i vulosur me autorizim te Keshillit Administrativ duhet te mabje edhe nenshkrimin e nje anetari te Keshillit Administrativ edhe nenshkrimin e sekretarit ose te nje anetari te dyte Keshillit Administrativ ose te nje personi tjetere, te caktuar nga Keshilli Administrativ.

KUPONET DHE REZERVAT

116. Shoqeria mundet qe ne Asamblete e Pergjithshme te caktojte kuponet, por asnje prej kuponeve nuk duhet te kaloje kuponin e propozuar nga Keshilli Administrativ.

117. Keshilli Administrativ, ne cdo kohe mund t'ju paguaje anetareve kupone te ndermjetme, te cilat duhet te justifikohen nga fitimet e shoqerise.

118. Asnje kupon nuk duhet te paguhet ndryshe nga fitimet e shoqerise

119. Keshilli Administrativ, para se te propozojte cdo kupon, duhet te mabje nga fitimet e shoqerise, sipas vendimit te tij, shuma per fondet rezerve. Keshilli Administrativ ka kopetencen e vecante qe te perdore per cdo qellim fitimet e shoqerise sic duhet. Keshilli Administrativ ka kpotence gjithshu qe ti disponoje keto fitime per operationet e shoqerise ose ti perdore, gjithmone sipas vendimit te tij, per investime te vecanta. Ai mund ti transferoje per perdorim tjetere ose ti perfshije ne fondet rezerve te shoqerise ato fitime qe nuk i parashikon per ti ndare.

120. Duke patur parasysh te drejtat e personave ne lidhje me kuponet, kuponet caktohen dhe paguhen ne proporcion me kuotat e derdhura per aksionet. Te gjitha

kuponet ndahen dhe paguhen ne proporcion me kuotat e derdhura per aksionet gjate intervalit kohor ose intervaleve kohore, qe jane caktuar per tu paguar kuponi.

121.Keshilli Administrativ mundet te heqe nga cdo kupon i pagueshem te anetarit cdo shume (nese ekziston), e cila duhet te paguhet nga ai tek shoqeria ne raport me aksionet e zoteruar prej tij.

122. Asamblea e Pergjithshme qe cakton kuponin ose bonon, mundet te vendose qe ky te paguhet teresisht ose pjeserisht nepermjet ndarjes se elementeve te vecante, kryesisht aksioneve te likujduara, letrave me vlere ose obligacioneve te cdo shoqerie tjeter. Ne rest se per ekzekutimin e nje vendimi te tille rezulton ndonje veshtiresi, Keshilli Administrativ interesohet per eliminimin e saj. Keshilli Administrativ mund te jape vertetime te vecanta dhe te caktoj vleren per ndarje te ketyre elementeve te vecante. Mundet te vendose qe pagesat kesh tek cdo anetar do te kryhen mbi bazen e vleres se caktuar prej tij.

123. Pagimi i kuponeve, interesave dhe shumave te tjera financiare, te pagueshme kesh ne raport me aksionet, mund te behet nepermjet dhenies se cekut ose mandat pageses, te derguar ne rruge postare ne adresen e regjistruar te zoteruesit dhe ne rastin e me shume se nje zoteruesi te nje aksioni, ne adresen e regjistruar te atij zoteruesi, emeri i te cilit eshte i regjistruar i pari ne Regjistrin e Anetareve. Keto ceqe ose mandatet e pagesave leshohen me urdher per personin qe ato dergohen. Ne rastin kur dy ose me shume persona zoterojne bashkarisht aksione, secili prej tyre mundet te leshoje vertetime te rregullta per cdo kupon, bono ose shume tjeter financiare, e pagueshme ne raport me aksionet e zoteruara prej tyre bashkarisht.

124.Asnje kupon nuk e rendon shoqerine me kamate.

LLOGARITE

125.Keshilli Administrativ duhet te kujdeset per mbajtjen e librave te kontabilitetit ne lidhje me:

- (a) Cdo shume financiare te arketuar dhe shpenzuar nga shoqeria si dhe qellimi per te cilin eshte arketuar ose shpenzuar kjo shume.
- (b) Cdo shitje dhe blerje mallrash nga shoqeria.
- (c) Aktivin dhe pasivin e shoqerise.

Librat e mbajtur, qe te konsiderohen te pershtatshem, duhet te perfshijne te gjitha te dhenat e kontabilitetit, te cilat duhet japin dhe pasqyrojne saktesisht dhe ligjerisht gjendjen e aktivitetit te shoqerise si dhe transaksionet e saj.

126.Librat e kontabilitetit duhet te ruhen ne zyren e regjistruar te shoqerise,ose ne zbatim te nenit 141(3) te Ligjit per shoqerite ato mund te ruhen edhe ne nje vend

tjeter, sipas vendimit te Keshillit Administrativ. Zyra ose vendi ku jane te depozituar librat e llogarise, nuk eshte e detyrueshme qe te jete gjithmeone hapur per ushtrimin e kontrollit nga anetaret e shoqerise.

127. Keshilli Administrativ, cdo here me vendim te tij, vendos per kohen, kushtet dhe rregullat mbi hapjen dhe kontrollin e bilanceve(llogarive) dhe librave te kontabilitetit nga anetaret e shoqerise, jo anetare te Keshillit Administrativ. Pra, asnje anetar nuk kate drejte te ushtroje kontroll ndaj cdo libri llogarie dhe dokumenti tjeter te shoqerise, pervec rastit kur kjo e drejte i jepet sipas ligjit ose me autorizim te Keshillit Administrativ ose nga Asamblea e Pergjithshme e Shoqerise.

128.Keshilli Administrativ, gjithmone duhet te kujdeset, ne zbatim te neneve 142,144 dhe 151 te Ligjit per Shoqerite, per pergatitjen dhe paraqitjen para Asamblese se Pergjithshme te shoqerise te llogarive te permendura ne keta nene, te humbje-fitimeve, bilanceve, llogarive te unifikuara dhe raporteve te vecanta.

129. Kopja e cdo bilanci, qe duhet te paraqitet ne Asamblene e Pergjithshme te shoqerise, bashke me kopjen e raportit te kontrolloreve, dergohen te pakten 21 dite para dates se mbledhjes se Asamblese tek cdo anetar i shoqerise, tek cdo zoterues i letrave me vlere te shoqerise si dhe tek cdo person i regjistruar ne baze te dispozites 37 te ketij Statuti.

KAPITALIZIMI I FITIMEVE

130. Shoqeria ne Asamblene e Pergjithshme te saj, me rekomandim te Keshillit Administrativ mundet te vendose kapitalizimin e cdo pjese te shumes, e cila, gjithmone, eshte e ruajtur per fontin rezerve te shoqerise ose per llogarite e fitim humbjeve, ose eshte e disponueshme per shperndarje midis anetareve te shoqerise ne formen e kuponeve, por me kushtin e pagimit jo kesh, ose per likujdimin e plote te aksioneve ose letrave me vlere te papaguara te shoqerise.

131. Perderisa per ceshtjet e mesiperme duhet marre vendim, Keshilli Administrativ kalon ne disponimin dhe perdorimin e fitimeve te pashperndara, per te cilat eshte vendosur kapitalizimi si dhe ne dhenien e mundeshme e aksioneve ose letrave me vlere, pergjithesisht kryen cdo veprim qe kerkohet per zbatimin e ketij vendimi.

KONTROLI I LLOGARIVE

132.Kontrolloret (revizoret) emerohen dhe detyrat e tyre rregullohen ne baze te neneve 153 deri 156 te Ligjit per Shoqerite.

LAJMERIMET

133. Lajmerimet jepen nga shoqeria tek anetaret e saj, te derguara ose ne rruge postare ne adresen e regjistruar ne Qipro, ose me njoftim ne adresen qe anetaret kane dashur qe ti japin shoqerise.

Ne rast se lajmerimet dergohen ne rruge postare, ato konsiderohen te dhena, n.q.se letra qe permban ato mban adresen e sakte dhe taksat e duhura. Ne rastin e lajmerimeve, te cilat i perkasin mbledhjes se Asamblese, ato konsiderohen te dhena kur mbrijne pas kalimit te 24 oreve nga dita e postimit.

134. Kur aksionet zoterohen bashkarisht nga me shume se nje (1) anetar , shoqeria mundet te dorezoje lajmerimin e saj tek anetari qe figuron i regjistruar i pari ne Librin e anetareve.

135. Persa i perket personave, te cilet kane fituar te drejten mbi aksionet per arsyje vdekje ose falimentimi te zoteruesit te aksioneve, shoqeria mundet ti dergoje lajmerimet e saj ne rruge postare me ane te letres qe permban pullat e nevojshme postare dhe me emrin e tyre personal ose me cilesine e tyre si perfaqesues te anetarit te vdekur ose te falimentuar ose me cdo cilesi tjeter te ngjashme , ne adrsen e regjistruar ne Qipro.

136. Lajmerimet qe i perkasin thirrjes se Asamblese se Pergjithshme, jepen sipas menyrave te parashikuara me lart, tek:

(a) Te gjithë anetaret, me perjashtim te atyre, te cilet (duke mos patur adrese te regjistruar ne Qipro) nuk deshirojne te njoftohen ne adresen e regjistruar ne shoqeri, brenda territorit te Qipros me ane te dhenies se lajmerimit.

(b) Cdo person qe eshte bere zoterues i aksioneve , per arsyje te cilesise se tij si perfaqesues i ligjshem i anetarit te vdekur ose te falimentuar, te drejte te marre lajmerimin per zhvillimin e mbledhjes se Asamblese.

(c) Secili kontrollor i shoqerise.

SHPERBERJA

137. Ne rast shperberje te shoqerise, likujdatori mundet, me vendim te jashtezakonshem te miratuar nga shoqeria dhe sipas dispozitave te Ligjit per Shoqerite, te beje ndarjen tek antaret e shoqerise, ne para ose natyre, te te gjithë elementeve te aktivitetit te shoqerise, duke percaktuar vleren e asetëve qe do te ndahen midis anetareve ose klasave te ndryshme te anetareve.

KOMPESIMET

138. Te gjithë anetaret e Keshillit Administrativ dhe personeli tjeter i shoqerise kane te drejte per kompesim nga elementet e aktivitetit te shoqerise, per cdo

demtim, duke perfshire kompesimet edhe per pergjesite ne zbatimin e detyrave te tyre, bazuar ne dispozitat e nenit 383 te Ligjit per shoqerite, sipas te cilit me vendim Gjykate antareve te Keshillit Administrativ ju jepet cdo kompesim i nevojshem.

VIJOJNE EMRAT DHE ADRESAT E NENSHKRUESEVE TE KETIJ
STATUTI

